



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË ZYRËS
SË KRYEMINISTRIT PËR VITIN 2019**

Prishtinë, Qershor 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Zyrës së Kryeministrit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina i cili e ka mbikëqyrë auditimin.


Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga udhëheqësja e ekipit Erëmira Bytyqi Pllana dhe anëtarët e ekipit, Refiçe Morina dhe Leonora Hasani, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Blerim Kabashi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	7
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	9
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	30
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	36
Shtojca II: Letër Konfirmimi	39

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Zyrës së Kryeministrit (ZKM) për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore ishin përgatitur në pajtim me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të keqklasifikimit të shpenzimeve dhe mbivlerësimit të shpenzimeve, të cilat kanë ndikuar në bazën për opinion të pamodifikura me theksim të çështjes.

Në PFV, ishin të nevojshme disa korrigjime financiare, të cilat pas vërejtjeve tona janë korrigjuar. Korrigjimet ishin bërë në këto pjesë të pasqyrave:

- Neni 14 Raporti i ekzekutimit të buxhetit/Hyrja e parasë së gatshme - Në kolonën Buxheti Final, si plan për realizimin e të hyrave, ishte prezantuar buxheti i të hyrave për shpenzime 323,000€, në vend se të prezantohet vlera të hyrave të planifikuara për realizim 5,024,000€, si dhe
- Neni 14.6 Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit/ndryshimet e autorizuara me ligj: Kategorita e ndarjes/Hyrjet - Në kolonën e buxhetit përfundimtar në SIMFK sipas Ligjit të Buxhetit , është prezantuar buxheti për shpenzime nga të hyrat në vlerë prej 323,000€, në vend se të prezantohet plani i të hyrave për realizim në vlerë prej 5,024,000€.

Procesi i menaxhimit financiar dhe kontrollit, ishte përcjellë me mangësi në disa fusha, si: (a) fusha e shpenzimeve, ku në disa raste nuk ishte marrë vlera e duhur për paranë e shpenzuar; (b) fusha e prokurimit, ku kishte pasur mangësi gjatë procesit të vlerësimit të ofertave; dhe (c) fusha e subvencioneve, ku nuk ishin respektuar procedurat e brendshme/rregulloret për procesin e ndarjes së tyre. Mos respektimi i procedurave të kërkuara ligjore dhe planifikimi jo i mirë i buxhetit, kishte rezultuar që nga shpenzimet e paparashikuara të ndahen mjete për projekte të planifikuara. Avanset, pasuritë dhe obligimet e papaguara, gjithashtu nuk ishin menaxhuar në mënyrën e duhur.

Zbatimi i rekomandimeve nuk ishte trajtuar me kujdesin e duhur. Prej tetë (8) rekomandimeve të dhëna për vitin 2018, vetëm një (1) ishte zbatuar, tri (3) ishin zbatuar pjesërisht, tri (3) nuk janë zbatuar, dhe një (1) i mbyllur i pazabuar.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i Pamodifikuar me Theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të ZKM për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht, shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Zyra e Kryeministrit është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar së do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Zyrës së Kryeministrit gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e ZKM-së, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Zyrës së Kryeministrit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i Pamodifikuar me Theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik të kontabilitetit në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjektet e audituara, në këtë rast nga Zyra e Kryeministrit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Theksimi i çështjes

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se si pasojë e planifikimit të dobët buxhetor me Ligjin për ndarjet buxhetore të vitit 2019, ZKM ka paguar dhe regjistruar shpenzime në kategori ekonomike jo adekuate në shumën 119,876€. Po ashtu, për shkak të ndarjeve joadekuate të fondeve me vendime të Qeverisë, kanë ndodhur edhe keqklasifikime tjera në shumën prej 101,375€, si dhe një pagesë prej 14,998€ nga ana e ZKM. Për shkak se gabimet kanë ndodhur qysh në fazën e aprovimit të ndarjeve buxhetore me Ligj, ne nuk e kemi kualifikuar opinionin lidhur me këto pagesa. Më hollësisht, këto çështje janë paraqitur në kapitullin 2.1 të këtij raporti.

Përveç keqklasifikimeve të mësipërme, shpenzimet për mallra dhe shërbime të paraqitura në PFV, ishin mbivlerësuar për vlerën prej 19,453€. Ky mbivlerësim kishte ndodhur tek avanset për udhëtime zyrtare dhe avanset për para të imtë. Pas kthimit të mjeteve në llogarinë e parasë së imtë, nuk janë bërë regjistrimet e duhura në regjistrat kontabël, ku si rezultat ka ardhur deri të paraqitja e vlerave jo të sakta të shpenzimeve për këtë kategori të shpenzimeve.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme

për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Zyrës së Kryeministrit.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia e ZKA është që të shpreh një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në faqen zyrtare të ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat ishin kryesisht efektive, ndërsa kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar pa rregullsitë. Kontrollet nuk ishin zbatuar me konsistencë, kryesisht në: realizimin e shpenzimeve në mungesë të dëshmive të mjaftueshme, kontraktimi i shërbimeve të veçanta pa procedura, realizimi i shpenzimeve me prokurim duke mos përfillur rregullat financiare dhe procedurat e kërkuara ligjore.

Fusha më problematike vazhdon të mbetet menaxhimi i subvencioneve dhe transfereve. Përkundër faktit se në këtë fushë edhe gjatë viteve të mëparshme janë identifikuar parregullsi të shumta dhe mos zbatim i kriterëve dhe rregulloreve për ndarjen e subvencioneve, ZKM nuk ka marrë masa për të korrigjuar dobësitë dhe mangësitë ekzistuese. Përkundrazi, situata mund të vlerësohet edhe më e keqe se vitin e kaluar. Menaxhmenti i ZKM duhet t'i hulumtoj shkaqet për një gjendje të tillë si dhe t'i shqyrtoj seriozisht gjetjet dhe rekomandimet e auditimit, dhe ndaj personave përgjegjës të aplikoj masa përgjegjësie.

Fusha tjera ku nevojiten përmirësime të mëtutjeshme janë: planifikimi dhe realizimi i buxhetit sipas kategorive adekuate, menaxhimi i projekteve dhe aplikimi i kontrolleve të shtuara mbi fushën e prokurimit. Mbikëqyrje më efektive duhet të aplikohet edhe në procesin e menaxhimit të avanseve, pasurive jo financiare si dhe menaxhimit të obligimeve të papaguara.

Auditimi i brendshëm në ZKM kishte funksionuar në mënyrë efektive, ndërsa në AUV ishte përcjellë me mangësi në realizimin e objektivave.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	Realizimi 2019	% e Realizimit 2019	Realizimi 2018	Realizimi 2017
Burimet e Fondeve:	18,554,041	18,050,448	14,689,013	81%	19,173,139	13,329,918
Granti i Qeverisë – Buxheti	18,081,487	16,025,038	13,663,293	85%	17,765,550	12,448,459
Të bartura nga viti paraprak ³ –	0	94,959	66,139	70%	93,386	88,405
Të hyrat vetjake ⁴	322,554	322,554	201,053	62%	227,594	222,418
Të hyrat nga AKP	150,000	116,244	27,692	24%	301,000	0
Donacionet e brendshme	0	19,611	0	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	1,472,042	730,836	50%	785,609	570,636

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 503,593€. Ky zvogëlim është rezultat i vendimeve të Qeverisë⁵, në bazë të deklaramit për kursime buxhetore/mjeteve të pashpenzuara në fund të vitit, në veçanti në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe investimeve kapitale, si pasojë e mos realizimit të projekteve të planifikuara.

Në vitin 2019, ZKM ka shpenzuar 81% të buxhetit final ose 14,689,013€, me një reduktim prej 11% krahasuar me vitin 2018. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të AUV të pashpenzuara në vitin paraprak, të bartura në vitin aktual

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake

⁵ Vendimi nr. 02/113 i datës 05.11.2019 dhe vendimi nr. 03/115 i datës 17.12.2019

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	Realizimi 2019	% e Realizimi mit 2019	Realizimi 2018	Realizimi 2017
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive	18,554,041	18,050,448	14,689,013	81%	19,173,139	13,329,918
Pagat dhe Mëditjet	4,901,685	5,252,060	5,164,963	98%	4,654,126	3,943,047
Mallrat dhe Shërbimet	10,004,108	8,801,002	6,360,803	72%	5,058,899	2,423,306
Shërbimet komunale	143,248	138,567	92,446	67%	95,502	84,626
Subvencionet dhe Transferet	2,565,000	2,872,332	2,626,880	91%	3,584,573	1,358,085
Investimet Kapitale	940,000	986,487	443,921	45%	5,780,039	5,520,854

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti final për paga dhe mëditje, në krahasim me buxhetin fillestar kishte shënuar rritje në vlerë 350,376€. Kjo rritje është si rezultat i vendimit të Qeverisë nr. 03/115, të datës 17.12.2019, në vlerë 235,206€ dhe donacioneve të jashtme në vlerë 115,170€. Shpenzimi në këtë kategori ishte 5,164,963€.
- Buxheti për mallra dhe shërbime, në raport me buxhetin fillestar, ishte zvogëluar për 1,203,106€, ndërsa shpenzimet ishin 6,360,803€. Fillimisht, kjo kategori kishte pasur rritje të buxhetit si rezultat i të hyrave nga viti paraprak në vlerë 94,959€, donacioneve të brendshme dhe të jashtme në vlerë 1,001,570€, si dhe 1,991,439€ në bazë të vendimeve të Qeverisë. Më pas, buxheti ishte zvogëluar për 2,944,357€ si rezultat i deklaramit të kursimeve buxhetore për mjetet e pashpenzuara në fund të vitit, përmes vendimit të Qeverisë nr. 02/113 të datës 05.11.2019, me ç rast buxheti ishte shkurtuar për 1,022,284€, si dhe vendimit të Qeverisë nr. 03/115 të datës 17.12.2019, ku buxheti ishte shkurtuar për 1,922,073€.

Rritja e buxhetit dhe shpenzimeve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në krahasim me vitin e kaluar, është si rezultat i financimit të projekteve nga kategoria e investimeve kapitale në kategorinë mallra dhe shërbime, të cilat në vitet e kaluara kishin qenë të buxhetuara gabimisht si projekte kapitale.

- Buxheti final për subvencione dhe transfere, kishte pësuar rritje në vlerë 307,332€. Kjo rritje ishte si rrjedhojë e donacioneve të brendshme dhe të jashtme në vlerë 99,332€, si dhe vendimeve të Qeverisë, të datës 17.12.2019 në vlerë 358,000€, dhe të datës 26.02.2019 në vlerë 5,000€. Ndërsa, si rrjedhojë e harmonizimeve të fund vitit, buxheti ishte shkurtuar për 155,000€. Shpenzimi në këtë kategori ishte 2,622,880€.

- Buxheti final për investime kapitale ishte 986,487€ ndërsa shpenzimet 443,921€ apo 45% e buxhetit final. Buxheti final në krahasim me atë fillestar kishte pasur rritje për 46,487€, si rezultat i vendimit të Qeverisë, nr. 02/113 i datës 05.11.2019. Nga gjithsej nëntë (9) projekte të planifikuara për realizim në vitin 2019, si pasojë e mos inicimit me kohë të procedurave të prokurimit, tre (3) nga to nuk ishin filluar fare.

Çështja B1- Keqklasifikimi i shpenzimeve sipas kodeve ekonomike

Gjetja Me rastin e analizës së pagesave sipas kodeve ekonomike, ne kemi gjetur se disa nga pagesat nuk janë bërë nga kodet adekuate. Pagesat kanë rezultuar me gabime për shkak të klasifikimit të gabuar qysh në fazën e aprovimit të Ligjit mbi ndarjet buxhetore. Gabimet kanë të bëjnë me rastet e mëposhtme:

- Pagesa në vlerë 68,000€, sipas kontratës për instalimin e pajisjeve të fabrikës së riciklimit “Furnizim me pajisje për asgjësimin e mbetjeve shtazore”, ishte paguar nga mallrat dhe shërbimet, ndërsa do të duhej të paguhej nga investimet kapitale pasi kjo kontratë ishte pjesë e projektit kapital “Ndërtimi i fabrikës së riciklimit”. Kjo kishte ndodhur pasi në vitin 2019 ky projekt ishte larguar nga tabelat e buxhetit për projektet kapitale, meqë Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) kishte kërkuar nga Ministria e Financave (MF) të largohen disa projekte jo kapitale nga tabelat e buxhetit për projekte kapitale që ishin buxhetuar gabimisht;
- Pagesat në vlerë 10,426€, për shërbimet e mirëmbajtjes së programit softuerik për kontrollin e importit dhe eksportit të kafshëve të gjalla dhe produkteve shtazore ishin paguar nga investimet kapitale, ndërsa i takojnë mallrave dhe shërbimeve; dhe
- Katër pagesa në vlerë 41,450€, për kompensimin e dëmit të fermerëve (asgjësimi i krerëve të gjedhit si pasojë e sëmundjeve infektive) janë paguar nga mallrat dhe shërbimet, edhe pse i takojnë subvencioneve dhe transfereve. Kjo kishte ndodhur pasi për vitin 2019, MF nuk i kishte aprovuar AUV-it buxhet në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve.

Me vendime të veçanta, Qeveria i kishte ndarë fonde ZKM-së në shumën 101,375€, të cilat po ashtu ishin ndarë në kode të gabuara ekonomike, në rastet si në vijim:

- Pagesa në vlerë 43,505€ për projektin “Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës hekurudhore në muzeun Bllaca”, ishin bërë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, përderisa kontrata ishte për punë dhe i takonin kategorisë së investimeve kapitale. Kjo kishte ndodhur pasi këto projekte nuk ishin planifikuar dhe aprovuar me kohë, në ligjin e buxhetit si projekte kapitale, dhe si rezultat ZKM nuk kishte pasur mjete në kategorinë e investimeve kapitale për t’i realizuar këto pagesa; dhe
- Pagesa në vlerë 57,870€, për dhënien e shpërblimeve për personelin arsimor dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA-të), nga Koordinatorin nacional për kulturë, rini dhe sport, e cila kishte të bënte me ndarjen e një shume të caktuar të mjeteve ndaj personelit të përzgjedhur

arsimor dhe të DKA-ve, ishte paguar nga mallrat dhe shërbimet, ndërsa i përket natyrës së shpenzimit të kategorisë së subvencioneve dhe transfereve.

Veç gabimeve me rastin e ndarjeve buxhetore, ZKM ka kryer pagesa në vlerë 14,998€ për projektin “Ndërtimi i Obeliskut” në oborrin e Qeverisë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, përderisa ishin kontrata për punë dhe i takonin kategorisë së investimeve kapitale.

Gabimet më sipër kanë ndodhur për shkak të planifikimit të dobët të buxhetit nga ana e Qeverisë dhe kujdesit të pamjaftueshëm të menaxhmentit të ZKM për të parandaluar ndarjet buxhetore në kodet e gabuara të shpenzimeve.

Ndikimi Pagesat e kyera nga kodet joadekuate të shpenzimeve ndikojnë në nëvlerësimin e disa llogarive dhe mbivlerësimin e llogarive tjera, që për efekt kanë paraqitjen e pa saktë apo keqpohimin e gjendjes së llogarive.

Rekomandimi B1 Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të bëhet ridestnimi i mjeteve sipas kërkesave ligjore) dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga AUV dhe ZKM në vitin 2019 ishin 5,558,383€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga taksat administrative, të hyrat nga inspektimet sanitare, fitosanitare dhe veterinare, të hyrat nga certifikatat, të hyrat nga shitja e gazetës zyrtare, etj.

Në këtë kategori kemi testuar gjithsej 50 teste substanciale dhe gjashtë teste të pajtueshmërisë. Me rastin e ekzaminimeve tona, ne nuk kemi gjetur ndonjë parregullsi për t’u raportuar.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	Pranimet 2019	Pranimet 2019 në %	Pranimet 2018	Pranimet 2017
Të hyrat	5,024,103	5,024,103	5,558,383	110%	5,691,685	5,731,908
Totali	5,024,103	5,024,103	5,558,383	110%	5,691,685	5,731,908

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje është 5,252,060€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 615, ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 568. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 31 të rinj. Për qëllime ekzaminimi, ne kemi testuar 96 mostra për teste substanciale në vlerë 161,787€, si dhe 16 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Gjatë testimeve tona, kemi hasur në një rast, ku kishim të bëjmë me pagesën e një shume retroaktive, ku ishte bërë pagesë prej 1,962€ përtej vlerës që duhej paguar. Ky gabim kishte ndodhur si pasojë e mos kontrollimit të duhur të listës së pagave nga ana e personelit. Pas vërejtjes tonë, zyra e personelit ka ndërmarrë masat dhe gjatë kohës sa ne ishim në auditim, më datë 26.02.2020 është bërë kthimi i mjeteve në llogarinë e Thesarit.

Çështja B2 Të punësuarit me marrëveshje për shërbime të veçanta pa procedura të rekrutimit dhe të angazhuar përtej afatit të lejuar ligjor

Gjetja Sipas Ligjit për Shërbimin Civil nr. 03/L-149, neni 12.4 - emërimet me afat të caktuar për një periudhë me të shkurtër se gjashtë (6) muaj bëhen në bazë të kontratave të quajtura "Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta" të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrime, dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtëzuar e rekrutimit.

Në tri (3) nga pesë (5) raste të testuara, për të punësuarit me marrëveshje për shërbime të veçanta, nuk ishin aplikuar procedura të thjeshtëzuara të rekrutimit, por angazhimi i tyre ishte bërë direkt përmes lidhjes së marrëveshjeve. Këto angazhime ishin bërë për pozitat: Ekspert mbështetës për nevoja të Zyrës për Çështje të Komuniteteve (ZÇK) dhe dy pozita për Zyrtar administrativ në Zyrën për Çështje të kategorive të dala nga Lufta. Për këta dy të fundit, ishin tejkuluar afatet e lejuara ligjore për angazhim, me ç'rast njëra kishte tejkulim gjashtë muaj, dhe tjetra një muaj. Ndërsa për ekspertin mbështetës, nuk ekziston asnjë raport pune brenda periudhës së angazhimit që konfirmon shërbimet/ekspertizën e ofruar nga ana e tij.

Lidhja e marrëveshjeve pa procedura, sa i përket ekspertit të angazhuar në ZÇK, kishte ndodhur pasi atij i kishte përfunduar angazhimi në një projekt të financuar nga Ambasada Britanike si pasojë e përfundimit të projektit, ndërsa më pas ZÇK ia kishte vazhduar kohëzgjatjen e angazhimit si ekspert duke lidhur marrëveshje në baza mujore përgjatë pesë mujorit të fundit të vitit 2019, me një kompensim mujor prej 6000€. Në marrëveshjet e lidhura, ceket se eksperti angazhohet për kryerjen e shërbimeve profesionale, por nuk ka një përshkrim më të detajuar se çka nënkuptohet me këto shërbime.

Ndërsa sa i përket dy zyrtarëve tjerë të angazhuar, ata ishin angazhuar përmes kërkesës direkte nga drejtori i këtij departamenti drejtuar kabinetit, për angazhimin e këtyre personave.

Ndikimi Angazhimi i nëpunësve me marrëveshje për shërbime të veçanta pa procedurë dhe në mungesë të transparencës, dëmton konkurrencën dhe rritë rrezikun e angazhimit të stafit jo kompetent për shërbimet e kërkuara. Ndërsa, angazhimi i tyre më gjatë se gjashtë muaj është në kundërshtim me dispozitat ligjore. Pagesat e kryera për ekspertin e angazhuar me MSHV pa asnjë raport pune brenda muajit, mund të karakterizohen si pagesa të parregullta, dhe nuk është e qartë nëse është arritur vlera për para për pagesat e kryera.

Rekomandimi B2 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se angazhimi i nëpunësve me marrëveshje për shërbime të veçanta, të bëhet vetëm pasi të jenë vlerësuar dhe arsyetuar nevojat për shërbimet specifike të tyre, dhe më pas, të zhvillohen procedurat e kërkuara ligjore, si dhe duke respektuar afatin e lejuar ligjor për kohëzgjatjen e angazhimit. SP dhe Drejtori i ZÇK duhet t'i rishikojnë pagesat enorme ndaj ekspertit të angazhuar në ZÇK dhe të kërkojnë raporte detaje mujore për kontributet/angazhimin e tij, si dhe të rishqyrtojnë nevojën e angazhimit të tij edhe gjatë vitit 2020 për këtë kompensim jashtë kriterëve.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2019 ishte 8,801,002€, ndërsa ishin shpenzuar 6,360,803€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, mëditjet dhe akomodimin gjatë udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, shpenzimet e telefonisë mobile, dreka zyrtare, mirëmbajtje të ndërtesave, shërbime kontraktuese, furnizime për zyrë, si dhe furnizime me pajisje mjekësore dhe preparate kimike.

Ne kemi përzgjedhur 100 njësi mostre për teste substanciale në vlerë 1,905,120€ si dhe 10 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Nga pagesat e testuara, kanë rezultuar çështjet që kanë të bëjnë më keq klasifikimet dhe mbivlerësimet e shpenzimeve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, të cilat janë trajtuar tek kapitulli Opinioni i Auditimit.

Nga testimi i pajtueshmërisë, kemi vërejtur se, bazuar në vendimin e Qeverisë nr. 11/57 të datës 17.07.2018, përmes të cilit ishte emëruar udhëheqësi i projektit për menaxhimin dhe kontrollin e qenve endacak. Detyrë e tij ishte mbikëqyrja e këtij projekti dhe përpilimi i rekomandimeve për Kryeministrinë, Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe partnerëve tjerë lidhur me këtë projekt. AUV kishte paguar udhëheqësin e projektit dhe vozitësin e tij, deri në tetor të vitit 2019, edhe pse ky projekt kishte përfunduar në dhjetor të vitit 2018. Pagesat e bëra gjatë vitit 2019 në vlerë 7,840€ ndaj këtyre dy personave, ishin bërë pa ndonjë raport për kryerjen e shërbimeve.

Vendimi për shfuqizimin e këtij emërimi, ishte marrë më datë 12.02.2020.

Çështja A1 Ndarja e mjeteve nga shpenzimet e paparashikuara, për projekte jo urgjente

Gjetja Sipas nenit 29 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nëse ndodhë një rast për të cilin nevojiten shpenzime urgjente ose të paparashikuara, organizata përkatëse buxhetore mund të aplikoj pranë Ministrit për fonde shtesë. Në aplikacion, ndër të tjera duhet të shpjegohen rrethanat të cilat kanë shkaktuar nevojën për fonde shtesë, të shpjegohen arsyet pse këto rrethana nuk kanë mundur të parashikohen dhe të identifikohen propozim shfrytëzimet e fondeve të kërkuara.

Në dy pagesa të testuara, të cilat kishin ndodhur si pasojë e nxjerrjes së vendimeve⁶ të Qeverisë, për transferimin e mjeteve nga shpenzimet e paparashikuara në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, nuk ishin respektuar procedurat e kërkuara të aplikimit për fonde shtesë në MF.

Për më tepër, natyra e shpenzimeve të ndodhura, nuk ishte e natyrës urgjente apo shpenzimeve të paparashikuara, pasi këto shpenzime do të duhej të planifikoheshin në buxhetin e rregullt të ZKM-së. Shpenzimet kishin të bënin me “Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës hekurudhore në muzeun Bllacë” në vlerë 47,558€ dhe pagesa tjetër për “Ndarja e shpërblimeve ndaj personelit arsimor dhe DKA-ve”, me rastin e organizimit dhe pjesëmarrjes në garat e Programit Nacional për Rini, në vlerë 57,870€.

Ndikimi Shpenzimi i mjeteve nga shpenzimet e paparashikuara të cilat janë të dedikuara për raste urgjente, për projekte të cilat kanë mund të planifikohen në buxhetin e rregullt, si dhe në mungesë të procedurës së kërkuar për aplikim në MF, ndikon në menaxhim jo të mirë të buxhetit dhe rritë rrezikun që ZKM të përballet me mungesë fondesh në raste urgjente ose situata të paparashikuara.

Rekomandimi A1 Sekretari i Përgjithshëm, duhet të siguroj se në bashkëpunim me Kabinetin e Kryeministrit, të bëhet identifikimi dhe vlerësimi i kërkesave për projektet që drejtohen tek Kryeministri, dhe bazuar në vlerësimin e bërë për këto projekte, ato të planifikohen në buxhetin e rregullt të ZKM-së. Gjithashtu, të sigurohet se mjetet nga rezervat, duhet të ndahen vetëm për raste urgjente dhe të paparashikuara, në pajtim me procedurat e kërkuara sipas LMFP.

⁶ Vendimi nr. 02/92 i datës 05.03.2019 Ndarja e mjeteve financiare në vlerë 100,000€ për mbulimin e shpenzimeve të Qendrës Përkujtimore për gjenocidin mbi shqiptarët “Bllacë 1999”, dhe Vendimi nr.18/115 i datës 17.12.2019 Ndarja e mjeteve financiare në vlerë 70,000€ për Zyrën e Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në kuadër të ZKM.

Çështja A2- Shpenzimet për dreka zyrtare pa dëshmi të mjaftueshme

E gjetura Bazuar në Rregullën financiare 01/2013 mbi shpenzimin e parasë publike, neni 24, të gjitha faturat duhet të pranohen duke zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit, me ç'rast duhet të sigurohet raporti i pranimit të mallit/shërbimit nga zyrtari/komisioni i autorizuar.

Në dy pagesa të testuara për dreka zyrtare, njëra në vlerë 8,400€, dhe tjetra në vlerë 8,750€, përveç faturave me mbishkrimet se shpenzimet kishin të bënin me rastin e organizimit të pritjeve/koktejeve të caktuara, nuk kishte raport pranimi, e as listë të pjesëmarrësve apo axhendë të bashkangjitur të ngjarjeve.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i neglizhencës së kabinetit në arsyetimin e shpenzimeve dhe komunikimit jo efektiv mes kabinetit dhe zyrës së financave.

Ndikimi Shpenzimet për dreka zyrtare, pa siguruar dëshmitë e mjaftueshme për qëllimin dhe shfrytëzuesit e shërbimeve, rritë rrezikun që paratë publike të shfrytëzohen për qëllime jo zyrtare.

Rekomandimi A2 Sekretari i Përgjithshëm, në bashkëpunim me kabinetin e Kryeministrit, duhet të siguroj se faturat e pranuar për dreka zyrtare nga kabinetin, të arsyetohen me dëshmi të mjaftueshme, duke përfshirë raportin e pranimit, agjendën e takimit, dhe faturën, me çka arsyetohet se shpenzimet janë bërë për/nga personat e autorizuar dhe për qëllime zyrtare. Në të kundërtën, pagesat e tilla duhet të ndërpriten.

Çështja B3 -Vonesë në mbylljen e avansit

Gjetja Sipas Procedurës për regjistrimin në SIMFK të avanseve për para të imta dhe avanseve për udhëtime zyrtare, përfituesi i avansit për udhëtim zyrtar obligohet që të bëjë arsyetimin e avansit, jo më larg se dy javë pas kthimit nga udhëtimi zyrtar.

Avansi i tërhequr me datën 20.09.2018 në vlerë 7,000€ për udhëtimin zyrtar në SHBA, nuk ishte mbyllur deri më datën 20.03.2019, respektivisht me pesë muaj vonesë. Mjetet e këtij avansi ishin përdorur edhe në udhëtime tjera nga i njëjti zyrtar, si në Kroaci, Turqi dhe Shqipëri. Ky avans ishte shpenzim nga zyra e Koordinatorit nacional për reforma shtetërore.

Vonesa në mbylljen e avansit kishte ndodhur për shkak të mos arsyetimit të faturave nga shfrytëzuesi i avansit, përkundër kërkesave nga zyra e financave.

Ndikimi Vonesat në mbylljen e avansit dhe mos arsyetimi i faturave nga shfrytëzuesit e avansit, rrisin rrezikun e mos kthimit të mjeteve tepriçë dhe shfrytëzimin e atyre mjeteve për qëllime jo zyrtare.

Rekomandimi B3 Sekretari i Përgjithshëm, në bashkëpunim me kabinetin e Kryeministrit, duhet të siguroj se janë vendosur kontrole rigoroze tek menaxhimi i avanseve për udhëtime zyrtare, në mënyrë që secili shfrytëzuesi i avansit të bëjë mbylljen e llogarive, respektivisht të barazohet me zyrën e financave, brenda dy javësh pas kthimit nga udhëtimi zyrtar.

Çështja A3 Vonesa në vlerësimin e ofertës dhe nënshkrimin e kontratës

Gjetja Sipas udhëzuesit operativ për prokurimin publik, neni 41.2: Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga Autoriteti Kontraktues brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti me kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.

Po ashtu, neni 31.3, i këtij udhëzuesi, thekson se periudha e kërkuar e validitetit të tenderit do të jetë jo më shumë se që është e nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënie dhe nënshkrimin e kontratës.

Tek procedura e prokurimit për "Shërbimet veterinarë në terren - Lloti 13 Komuna Istog" në vlerë 166,132€, kemi vërejtur që nuk janë respektuar afatet e vlerësimit të ofertave, të parapara sipas udhëzuesit të prokurimit. Kjo pasi, procesi i vlerësimit kishte filluar me 19 ditë vonesë pas përfundimit të hapjes së tenderëve, ndërsa përfundimi i procesit të vlerësimit nga komisioni, ishte bërë me vonesë prej 56 ditësh nga periudha e lejuar. Gjithashtu, raporti i vlerësimit nga zyrtari i prokurimit ishte nënshkruar një muaj pas përfundimit të vlerësimit nga ana e komisionit vlerësues.

Si rrjedhojë, edhe kontrata me përfituesin ishte nënshkruar me vonesë, jashtë validitetit të tenderit. Validiteti i tenderit ishte 120 ditë, ndërsa nënshkrimi i kontratës ishte bërë 16 ditë pas skadimit të validitetit të tenderit.

Sipas zyrtarit të prokurimit këto vonesa ishin shkaktuar për shkak të numrit të madh të ofertave (procedura është zhvilluar për 37 lloje - komuna) dhe sfidave tjera të dala gjatë procesit, si dhe vonesave nga OE për të sjellur dokumentet e përshtatshme.

Ndikimi Vonesat në përmbylljen e procesit të vlerësimit të ofertave, ndikojnë në vonesën e nënshkrimit të kontratave, duke shkaktuar kështu marrjen me vonesë të shërbimeve të kontraktuara dhe pengesa në realizimin e objektivave të organizatës.

Rekomandimi A3 Drejtori Ekzekutiv i AUV duhet të siguroj që procedurat e vlerësimit të ofertave të përfundohen brenda afateve të parapara kohore, si dhe kontratat të nënshkruhen me kohë, siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi.

Çështja A Mungesa e planit të menaxhimit dhe vendimit për menaxher të kontratës

Gjetja Sipas udhëzuesit të prokurimit publik, pika 61.4, pasi të jetë nënshkruar kontrata nga të dy palët, zyrtari përgjegjës i prokurimit do ta informojë Zyrtarin Kryesor Administrativ (ZKA), dhe ZKA me shkrim do ta emërojë një Menaxher të Projektit përgjegjës për menaxhimin (mbikëqyrjen) e kontratës specifike;

Më tutje, pika 61.7 dhe 61.8, thekson se pas pranimit të kontratës, menaxheri i projektit do të përgatis një plan për menaxhimin e kontratës, duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP. Plani i menaxhimit të kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës.

Për kontratën “**Shërbimet veterinare në teren-Lloti 13 Komuna Istog**”, në vlerë 166,132€, menaxheri i kontratës nuk ishte emëruar pas nënshkrimit të kontratës, megjithatë vendimi për emërimin e menaxherit të kontratës ishte marrë në mars të vitit 2020, ndërsa kontrata ishte nënshkruar në shtator të vitit 2019. Më tutje, plani i menaxhimit të kontratës nuk ishte përgatitur, edhe pse kontrata kishte filluar të zbatohet.

Kjo kishte ndodhur për shkak të neglizhencës dhe mungesës së mbikëqyrjes nga ana e menaxhmentit.

Pas pranimit të draft raportit, AUV ka ndërmarrë masa të menjëhershme dhe ka përgatitur planin e menaxhimit të kontratës. Meqenëse veprimet përmirësuese janë marrë menjëherë, ne nuk kemi dhënë rekomandim për këtë çështje.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 2,872,332€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 2,626,880€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me mjetet e ndara nga programi i Zyrës për Çështje të Komuniteteve (ZÇK) në kuadër të ZKM-së, për subvencionimin e personave fizik dhe OJQ-ve, si dhe subvencionet e ndara në kuadër të programit të Zyrës së Kryeministrit për entitetet jopublike. Në këtë fushë, ne kemi testuar 74 mostra për teste substanciale në vlerë 696,028€ si dhe 20 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja C1 - Mungesa e procesit të vlerësimit gjatë ndarjes së subvencioneve për persona fizik**Gjetja**

Bazuar në Programin për Komunitete, të miratuar nga Kryeministri, për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për ndarjen e subvencioneve nga Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK) në ZKM, neni 11, thekson se Sekretari i Përgjithshëm i ZKM, me propozimin e ZÇK, themelon komisionin për shqyrtimin e kërkesave dhe projekteve për ndarjen e subvencioneve për personat fizik dhe juridik.

Në gjashtë raste të testuara, në vlerë 28,550€, ku përfitues të subvencioneve nga ZKM ishin personat fizik, mjetet ndaj këtyre të fundit ishin ndarë në mungesë të vlerësimit nga një komision vlerësues, por vetëm duke u bazuar në kërkesën individuale drejtuar zyrës për komunitete. Më tutje, këto kërkesa ishin dërguar për aprovim në kabinetin e Kryeministrit nga drejtori i ZÇK-së, dhe të njejtat ishin aprovuar përmes vendimeve të Kryeministrit, për ndarjen e mjeteve ndaj këtyre përfituesve.

Kërkesat e parashtruara, nuk ishin bërë përmes formularit të aplikimit, siç kërkohet në këtë program, pasi formulari nuk ishte i publikuar nga ZÇK në faqen zyrtare. Ato kryesisht kishin të bënin me ndihmë financiare për renovim të shtëpisë, megjithatë nuk arsyetonin mjaftueshëm nevojën për ndihmën e kërkuar.

Në katër raste tjera të testuara të përfituesve fizik, në vlerë 17,500€, të cilët ishin përzgjedhur përmes komisionit të vlerësimit, kemi vërejtur se njëri anëtar i komisionit të vlerësimit ishte zëvendësuar, pasi ky i fundit kishte munguar për shkaqe shëndetësore.

Zëvendësimi i anëtarit nuk ishte bërë me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm (SP), por vetëm me njoftim nga Drejtori i zyrës për komunitete drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Ky njoftim për emërim ishte bërë pas përgatitjes së raportit të vlerësimit nga komisioni. Vlen të theksohet se përfituesit, përveç kërkesës individuale, nuk kishin asnjë dëshmi tjetër që do të arsyetonte ndihmën e kërkuar.

Mos caktimi i komisionit të vlerësimit, kishte ndodhur pasi zyra për komunitete nuk kishte propozuar formimin e një komisioni për vlerësimin e kërkesave të personave fizik, pasi sipas tyre, të gjitha kërkesat ishin me urgjencë dhe me urdhër të Kabinetit. Ndërsa zëvendësimi i anëtarit të vlerësimit, pa vendim nga Sekretari i Përgjithshëm, kishte ndodhur si rezultat i neglizhencës nga ZÇK për të njoftuar me kohë zëvendësimin e anëtarit të komisionit.

Ndikimi Mungesa e procesit të vlerësimit nga komisioni vlerësues në ndarjen e subvencioneve ndaj personave fizik, rrezikon transparencën në procedurat e vendimmarrjes, mundësinë e ndarjes së mjeteve personave jo meritore, dhe pa një qëllim të qartë të ndarjes së fondeve. Më tej, kryerja e vlerësimit nga anëtarë të cilët nuk janë të caktuar me vendim të SP, rritë rrezikun e rregullsisë së procesit të vlerësimit.

Rekomandimi C1 Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i ZÇK-së, duhet të sigurojnë se për çdo proces të ndarjes së subvencioneve ndaj personave fizik, të formohet komisioni i vlerësimit i cili do të bëjë vlerësimin e kërkesave bazuar në dëshmi të mjaftueshme për arsyetimin e dhënies së ndihmës. Në rast të ndryshimit të përbërjes së komisionit, kjo të bëhet përmes vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm.

Çështja A4 - Ndarja e subvencioneve ndaj OJQ-ve duke mos respektuar rregulloren në fuqi

Gjetja Sipas Rregullores 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit të OJQ-ve neni 12, thekson se: çdo mbështetje financiare për OJQ-të duhet të shpallet me thirrje publike, e cila duhet të publikohet në ueb faqen e ofruesit të mbështetjes financiare. Po ashtu, sipas nenit 8, ofruesi i mbështetjes financiare, duhet të themeloj komisionin vlerësues, i cili do të merret me vlerësimin e aplikacioneve sipas thirrjes publike dhe të bëjë përzgjedhjen e përfituesve.

Në katër raste të testuara në vlerë 53,000€, ku përfitues ishin OJQ-të lidhur me organizimin e festave të komuniteteve si dhe organizime të koncerteve në kampin multietnik, ZÇK nuk kishte aplikuar shpalljen për thirrje publike, si dhe nuk kishte caktuar një komision vlerësimi. Përzgjedhja e këtyre OJQ-ve ishte bërë në bazë të kërkesave direkte të tyre në ZÇK, aprovimit nga kabineti i Kryeministrit, dhe më pas, lidhjes së marrëveshjeve me drejtorin e ZÇK-së.

Në dy nga këto raste, kërkesat për organizim të festave memoriale ishin bërë nga Këshilli Organizativ i Festës Memoriale të Romëve të Kosovës, si dhe kërkesa nga Këshilli Organizativ i Festës Memoriale të Komunitetit Turk, ndërsa marrëveshjet për ndarjen e mjeteve, ishin bërë me OJQ të cilat nuk kishin parashtruar kërkesë lidhur me këto organizime dhe për të cilat nuk kishte ndonjë dëshmi se si ishte vendosur përzgjedhja e tyre.

Sipas drejtorit të ZÇK-së, këto OJQ ishin përzgjedhur në bashkëpunim me Këshillat Organizative të këtyre komuniteteve, megjithatë pas kërkesës tonë, nuk u ofruan dëshmi të tilla.

Këto mangësi kishin ndodhur si pasojë e planifikimit të dobët të ndarjes së subvencioneve për OJQ-të nga ZÇK, dhe mos respektimit të rregullores qeveritare mbi financimin e OJQ-ve.

Ndikimi Ndarja e subvencioneve duke mos respektuar kërkesat e rregullores në fuqi, ngrit dyshime nëse fondet janë përdorë për qëllimet e synuara, dhe në pajtim me kriteret dhe procedurat e përcaktuara me rregullore. Kjo mundëson vendim marrje subjektive gjatë përzgjedhjes së përfituesve.

Rekomandimi A4 Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i ZÇK-së, duhet t'i analizojnë shkaqet se pse rastet e mëspërme kanë ndodhur dhe të marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e praktikave të tilla. Gjithashtu, në fazat e ardhme të sigurojnë se përzgjedhja e OJQ-ve bëhet ekskluzivisht në pajtim me kriteret, standardet dhe procedurat e përcaktuara me Rregulloren nr.04/2017.

Çështja A5- Ndarja e subvencioneve ndaj OJQ-ve duke mos respektuar kriteret specifike të thirrjes publike

Gjetja Bazuar në thirrjen publike për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve në forcimin dhe promovimin e aktivitetit kulturor dhe mendimit kritik nga Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport (KNKRS), tek kriteret specifike kërkohet:

(a) aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë përvojë në realizimin e projekteve, duke siguruar dëshmi të realizimit të projekteve në të kaluarën; dhe

(b) të dorëzojnë të dhëna për personelin kyç, duke specifikuar detyrat, CV-të dhe deklaratat e pranimit se do të angazhohen në këtë projekt.

Në dy raste të subvencionimeve (11,900€ dhe 15,420€) OJQ-të përfituese të subvencioneve të ndara nga KNKRS, gjatë aplikimit nuk kishin përmbushur të gjitha kriteret specifike, pasi nuk kishin siguruar dëshmitë mbi realizimin e projekteve në të kaluarën. Megjithatë, aplikacionet e tyre ishin kualifikuar për mbështetje financiare dhe të njëjtat ishin përzgjedhur si përfituese të subvencioneve.

Njëra OJQ përfituese, në aplikacionin e saj kishte deklaruar se numri i personave të punësuar të përfshirë në zbatimin e projektit është dy, ndërsa kishte siguruar të dhënat vetëm për njërin të angazhuar (menaxherin e projektit). Duhet cekur se në vlerësimet e komisionit, tek kërkesa se a posedon kjo organizatë kapacitete të mjaftueshme (duke përfshirë personelin), komisioni kishte vlerësuar pozitivisht, ndonëse aplikuesi kishte ofruar dëshmi të angazhimit vetëm për një të punësuar.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i neglizhencës së komisionit të vlerësimit, për t'i vlerësuar aplikacionet e OJQ-ve në pajtim me kërkesat e vendosura në thirrjen publike.

Ndikimi Financimi i OJQ-ve, në mungesë të sigurimit të dokumentacionit përkatës sipas kriterëve të përcaktuara, rritë rrezikun që projektet e subvencionuara të mos realizohen në mënyrë të suksesshme dhe redukton mundësinë e angazhimit të aplikuesve tjerë.

Rekomandimi A5 Sekretari i Përgjithshëm, duhet të siguroj se në rastet e thirrjeve publike për OJQ-të, të respektohen të gjitha kriteret e përcaktuara sipas thirrjes gjatë vlerësimit të aplikacioneve nga komisioni përkatës i vlerësimit.

Çështja A6- Përzgjedhja e OJQ-ve si përfituese, pa siguruar dokumentacionin e kërkuar pas rezultateve preliminare

Gjetja Bazuar në Rregulloren MF nr. 04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 20, pika 3, komisioni vlerësues kërkon nga aplikuesit e përzgjedhur në listën e rezultateve paraprake, dokumentacionin në vijim:

(a) dëshmi se kanë kryer të gjitha obligimet tatimore dhe kontributet pensionale sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës; ose në rast të ekzistencës së detyrimeve, dëshmia e një marrëveshje me autoritetet tatimore për përmbushjen e detyrimeve të tilla;

(b) dëshmia se OJQ nuk është në procedurë të shuarjes dhe ç' regjistrimit; dhe

(c) dëshmi të dorëzimit të deklaratës vjetore tatimore ose pasqyrave financiare të vitit paraprak të dorëzuara sipas kërkesave të legjislacionit tatimor për vitin paraprak.

OJQ përfituese e subvencionit prej 3,150€ nga Agjencia për Barazi Gjinore, pas vlerësimit pozitiv se kishte plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në thirrjen publike, kishte sjellur vërtetimin tatimor, ku vërtetohej se personi ishte i regjistruar në ATK dhe se kishte borxhe tatimore apo obligime tjera tatimore të pashlyera.

Më tutje, katër OJQ përfituese të subvencioneve (16,870€, 14,680€, 15,270€ dhe 16,110€) nga Zyra e Koordinatorit Nacional për Rini dhe Sport, pas përzgjedhjes, nuk kishin siguruar dëshmitë se nuk janë në procedurë të shuarjes dhe ç' regjistrimit, si dhe dëshmitë mbi dorëzimin e deklaratës vjetore tatimore ose pasqyrave financiare të vitit paraprak të dorëzuara sipas kërkesave të legjislacionit tatimor për vitin paraprak.

Mangësitë e ndodhura, ishin shkak të neglizhencës së komisionit të vlerësimit, për sigurimin e dëshmimeve të mjaftueshme, pas fazës së përfundimit të vlerësimeve.

Ndikimi Mos sigurimi i të gjitha dëshmive pas shpalljes së rezultateve preliminare sipas kërkesave të rregullores, rrezikon që të jenë përzgjedhur përfituesit jo meritore dhe të diskriminohen aplikantët tjerë të mbetur jashtë listës paraprake me më së shumti pikë, të cilët do të mund të ishin të përgjegjshëm në sigurimin e të gjitha dëshmive.

Rekomandimi A6 Sekretari i Përgjithshëm, duhet të siguroj se OJQ-të e përzgjedhura në listën preliminare, të sigurojnë gjithë dokumentacionin që kërkohet pas shpalljes së rezultateve preliminare sipas kërkesave të rregullores në fuqi.

Çështja B4 - Mungesa e raportimit nga përfituesit e subvencioneve

E gjetura Sipas Programit për Komunitete, për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për ndarjen e subvencioneve nga ZÇK, neni 17, personat fizik dhe juridik janë të obliguar të dorëzojnë raport narrativ në ZÇK për ecurinë e implementimit të subvencionit apo transferit, ndërsa 30 ditë pas realizimit të projektit, janë të detyruar të dorëzojnë raportin përfundimtar narrativ, raportet financiare dhe të ofrojnë dëshmi se subvencionit apo transferi është realizuar sipas planit dhe në pajtim të plotë me këtë program.

Në katër, nga pesë raste të testuara, për persona fizik të cilët ishin përfitues të subvencioneve nga Zyra për Çështje të Komuniteteve, nuk kanë dorëzuar raportet financiare apo dëshmitë mbi realizimin e planit për të cilin janë marrë mjetet.

Në një nga katër raste të testuara, ku përfitues ishin personat juridik (OJQ-të), OJQ e cila ishte përfituese e subvencionit në vlerë 9000€, kishte sjellur dëshmi që arsyeton vetëm shumën prej 6,683€, dhe jo shumën totale të përfituar.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i pa përgjegjshmërisë së përfituesve dhe monitorimit jo të mjaftueshëm nga komisioni për monitorim.

Ndikimi Mos raportimi i mjeteve të shpenzuara, mungesa e faturave dhe sigurimi i faturave që nuk dëshmojnë se mjetet janë shpenzuar në përputhje me qëllimin e dhënë, mund të rezultoj me devijime nga qëllimet e përfitimit të mjeteve dhe humbjen e vlerës për paratë e shpenzuar

Rekomandimi B4 Sekretari i Përgjithshëm, të siguroj ndërmarrjen e masave shtesë ndaj monitorimit të përfituesve nga personat fizik dhe OJQ-të, për sigurimin e dëshmive të vlefshme lidhur me shfrytëzimin e mjeteve, në përputhje me qëllimin e dhënë. Nëse këto nuk arsyetohen brenda periudhës së definuar në kontratë, të ndërmerren masa ndëshkuese ndaj këtyre përfituesve, siç janë të përcaktuara në programin e miratuar për komunitete.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 986,487€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 443,921€. Ato kanë të bëjnë me pagesat e realizuara nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, lidhur me ndërtimin e Fabrikës së përpunimit të nënprodukteve shtazore, renovim të objekteve, pagesa e pajisjeve laboratorike dhe mirëmbajtja e sistemit softuerik. Ne kemi testuar nëntë (9) mostra për teste substanciale në vlerë 440,921€, si dhe dy (2) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështjet që kanë të bëjnë me keqklasifikimet e realizuara nga kategoria e investimeve kapitale, janë trajtuar tek kapitulli Opinioni i Auditimit.

Çështja B – Pagesa për punët e papërfunduara

Gjetja

Bazuar në memorandumun e mirëkuptimit mes Ministrisë së Administratës Publike (MAP) dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), për realizimin e projektit kapital "Renovimi e objektit të ASK-së" është përcaktuar që MAP do të emëroj organin mbikëqyrës për realizimin e projektit, si dhe për realizimin e pagesave për punët e kryera. MAP obligohet që, ndër të tjera, të siguroj raportin e punëve të kryera (situationet e aprovuara).

Menaxheri i projektit kishte aprovuar çertifikatën e parë të pagesës në vlerë 27,692€, në dhjetor të vitit 2019, për situacionin e parë të punëve të kryera të kontratës "Renovimi i sanitarisë, ngjyrosja e mureve dhe dyshemesë në hapësirat e ASK-së", duke vërtetuar se kontraktori ka kryer punët sipas specifikacioneve të kontratës.

Ne gjatë vizitës tonë në ASK, kemi bërë ekzaminimin fizik të disa pozicioneve të situacionit të aprovuar nga organi mbikëqyrës. Gjatë ekzaminimit të pozicionit 9.0 (Punët e dyerve dhe dritareve), përkatësisht pozicionit 9.2, ku në situacionin e aprovuar ceket se janë furnizuar dhe vendosur gjithsej 12 dyer, nga ekzaminimi jonë ka rezultuar se janë vendosur gjithsej nëntë (9) dyer. Vlera e paguar për këtë pozicion (për 12 dyer) është 2,760€, ndërsa vlera për punët e kryera bazuar në ekzaminimin tonë është 2,070€.

Sipas menaxherit të projektit, nga gjithsej 12 dyer të furnizuara janë vendosur nëntë prej tyre për shkak të pa mundësisë për të qëndruar në objekt, tri prej tyre janë rikthyer.

Pas pranimit të draft raportit dhe diskutimeve me menaxhmentin, ASK ka ndërmarrë masa, dhe ka siguruar dëshmitë se janë vendosur edhe tri dyert tjera të cilat mungonin me rastin e ekzaminimeve tona fizike.

Pasi që veprimet përmirësuese nga menaxhmenti janë ndërmarrë para se raporti të finalizohet, lidhur me këtë çështje ne nuk kemi dhënë rekomandim.

Çështja A7- Dobësi në procesin e prokurimit

Gjetja Në dosjen e tenderit “Ndërtimi i Obeliskut”, tek kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, është kërkuar që operatori ekonomik (OE) të dorëzojë certifikatën ISO Standarde 9001/2015, ndërsa tek kërkesat mbi mundësitë teknike/profesionale, është kërkuar që të sigurojë stafin e kualifikuar duke dëshmuar me kopjen e diplomave dhe kontratave të punës.

Ndonëse ishte vetëm një ofertues, OE i vlerësuar si i përgjegjshëm dhe i shpallur fitues, nuk kishte siguruar dokumentet e kërkuara, me ç'rast, certifikata ISO standarde të cilën e kishte siguruar, ishte ISO 9001:2008 dhe e njëjta kishte skaduar në vitin 2018, ndërsa tek dëshmia e stafit, kontrata e punës së inxhinierit të ndërtimtarisë të angazhuar në këtë projekt, me OE në fjalë, kishte skaduar në vitin 2013.

Kjo kishte ndodhur, pasi këto mangësi nuk ishin vërejtur nga komisioni i vlerësimit dhe as nga zyra e prokurimit, meqë projekti ishte realizuar me afate të përshpejtuara për shkak të inicimit të vonshëm të tij.

Ndikimi Përzgjedhja e OE si i përgjegjshëm, në mungesë të përmbushjes së të gjitha kërkesave sipas dosjes së tenderit, ndikon në përzgjedhjen e kontraktorit jo të duhur për realizimin e projektit, dhe mos realizimin e projektit sipas cilësisë së kërkuar.

Rekomandimi A7 Sekretari i Përgjithshëm, duhet të sigurojë se vlerësimi i tenderëve bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe vetëm operatorët e përgjegjshëm në të gjitha kërkesat shpallen fitues.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 7,722,556€, pasurive jokapitale 209,378€, dhe e stoqeve 415,025€. Ne kemi testuar 11 mostra për teste substanciale në vlerë 439,581€, si dhe pesë (5) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja C2 - Mos regjistrimi i pasurive kapitale në SIMFK

Gjetja Bazuar në rregulloren mbi pasurinë jo financiare⁷, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jokapitale dhe stoqet në sistemin e pasurisë.

⁷ Rregullore MF nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizata buxhetore, neni 6

Pajisja e blerë në vlerë 21,903€, në bazë të kontratës Shërbimet e servisimit dhe mirëmbajtjes laboratorike, në AUV, nuk ishte regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale.

Poashtu, dy llaptopë të blerë në ASK, financuar nga donacioni IPA 2014, që vlerën për njësi e kishin 1,830€ nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale.

Pajisja e blerë në AUV, nuk ishte regjistruar për shkak se ishte pranuar në sektorin që kishte bërë kërkesën, duke mos kaluar dhe regjistruar fillimisht në sistemin e deposë, dhe si rezultat, zyrtari i pasurisë nuk kishte qenë i informuar për blerjen e pajisjes. Pas pranimit të draft raportit, AUV kishte marrë masa për regjistrimin e pasurisë. Ndërkaq mos regjistrimi i llaptopëve në ASK, për shkak se blerja e tyre ishte bërë nga kategoria jo e duhur, (mallrave dhe e shërbimeve), dhe si të tillë, zyrtari i pasurisë nuk ka mundur t'a regjistroj në SIMFK.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurive kapitale, ndikon në kontrollin e dobët mbi menaxhimin e pasurive, si pasojë e mungesës së informacionit mbi pasuritë që zotëron organizata, si dhe nënvlerësimin e tyre në pasqyrat financiare vjetore.

Rekomandimi C2 Drejtori Ekzekutiv në AUV, duhet të ndërmerr masa që të gjitha furnizimet fillimisht të pranohen përmes deposë qendrore ku dhe regjistrohen në sistem, dhe më pas të shpërndahen në sektorët e caktuar sipas kërkesës. Ndërsa, Kryeshefi Ekzekutiv në ASK, të siguroj se blerjet mbi 1000€ realizohen nga kategoria e investimeve kapitale dhe si të tilla, regjistrohen në regjistrin kontabël.

2.3 Të arkëtueshmet

ZKM në PFV e vitit 2019 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 5,174€. Këto kishin të bënin me çertifikata shëndetësore veterinarë, çertifikata të therjes së kafshëve, dhe çertifikata të artikujve me origjinë shtazore. Ne kemi testuar gjithsej pesë (5) mostra për qëllime substanciale dhe tri (3) mostra për pajtueshmëri. Testet tona nuk kanë rezultuar me parregullsi në këtë fushë.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2019, ishte 191,151€⁸. Këto detyrime kishin të bënin me kryesisht me fatura të papaguara nga mallrat dhe shërbimet lidhur me karburantet për vetura, dreka zyrtare, mirëmbajtje, furnizime për zyre, analiza laboratorike, pagesa për anketues. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020, ndërsa arsyeja e mos pagesës kishte të bënte me mbylljen e

⁸ Kjo shumë është prezantuar nga entiteti i audituar

vitit fiskal dhe mungesën e buxhetit . Ne kemi testuar gjithsej pesë mostra për qëllime substanciale dhe gjashtë mostra për pajtueshmëri.

Çështja B5 – Vonesat në pagesën e faturave të papaguara

Gjetja Bazuar në neni 37, të Rregullës Financiare 01/2013 mbi shpenzimin e parave publike, të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore duhet të paguhen brenda 30 ditëve, nëse nuk është paraparë ndryshe me kontratë.

Në tri raste të pagesave të testuara, njëra në ZKM në vlerë 26,828€ dhe dy në AUV në vlerë 369,000€, kemi vërejtur se pagesat ishin paguar pas afatit të përcaktuar ligjor, me vonesë deri në katër muaj. Gjithashtu, nga testimi i obligimeve të shpalosura në PFV, kemi vërejtur se një pagesë në vlerë 22,520€ nuk ishte paguar brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Vonesat kishin ndodhur si pasojë e mungesës së mjeteve, për shkak të hyrjes në obligime në mungesë të mjeteve të zotuara.

Ndikimi Mos realizimi i pagesave brenda afatit të caktuar ligjor, mund të rrezikoj realizimin e shpenzimeve të parapara për vitin aktual, si pasojë e borxheve të papaguara. Po ashtu, kjo mund të rezultojë me pagesa përmes vendimeve gjyqësore apo vendimeve të Thesarit, të cilat bartin në vete kosto shtesë.

Rekomandimi B5 Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori Ekzekutiv në AUV, të sigurojnë se të gjitha faturat e pranuar, paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh.

2.4.2 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2019, ishte 564,315€. Këto kishin të bënin me padi gjyqësore ndaj AUV lidhur me kompensimin e dëmit për kafshët e asgjësuara.

2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Vlera e detyrimeve kontraktuale të ZKM-së, që pritet të realizohen në vitet në periudhën 2020-2022 është 1,150,310€, ndërsa e atyre të AUV është 3,830,667€.

2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në ZKM, përbëhet nga dy auditor, dhe ndaras nga kjo njësi, vepron edhe një auditor i brendshëm në AUV.

Në kuadër të ZKM-së është i themeluar Komiteti i Auditimit, i cili gjatë vitit 2019 ka mbajtur tri takime.

ZKM për vitin 2019 kishte planifikuar katër (4) auditime, me ç'rast kishte arritur t'i përfundoj të gjitha. Fushat e mbuluara të auditimit, kishin të bënin me prokurimin, menaxhimin e subvencioneve, si dhe menaxhimin e dy agjencive në kuadër të ZKM-së, ndërsa mbulonin periudhën 2018 në fushën e prokurimit, dhe fushat tjera periudhën 2019. Në këto raporte, ishin dhënë gjithsej 28 rekomandime. Prej tyre, tetë (8) ishin zbatuar, 12 ishin në proces të zbatimit dhe tetë (8) të pazbatuara.

Ndërsa, auditori i brendshëm në AUV, kishte planifikuar kryerjen e pesë (5) auditimeve për vitin 2019, ndërsa kishte përfunduar katër (4) prej tyre. Fushat e mbuluara të auditimit, kishin të bënin me të hyrat, personelin, menaxhimi i pasurisë në AUV dhe menaxhimi i kontrollit të brendshëm në drejtorinë e shëndetit publik, ndërsa auditimi që nuk ishte realizuar kishte të bëjë me fushën e prokurimit. Këto auditime mbulonin fushëveprimin e periudhës 2018 në fushën e menaxhimit të pasurive, dhe vitin 2019 për fushat tjera. Gjithsej ishin dhënë 23 rekomandime, prej të cilave, katër (4) ishin zbatuar plotësisht, 10 në proces të zbatimit dhe një (1) i pazbatuar, ndërsa për pjesën tjetër ende nuk ishte raportuar.

Në kuadër të ZKM-së është i themeluar Komiteti i Auditimit, i cili gjatë vitit 2019 ka mbajtur tri takime. Në këto takime, nuk ishte ftuar të merrte pjesë auditori i brendshëm në AUV, përkundër se ky ishte një rekomandim paraprak për të rritur bashkëpunimin e ndërsjellë.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të ZKM-së ka rezultuar në tetë (8) rekomandime kryesore. ZKM kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

ZKM ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve për gjashtë mujorin e parë më 30 shtator, sipas kërkesave të dala nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit, ndërsa për gjashtë mujorin e dytë më 15 mars nuk e ka dorëzuar.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, një (1) rekomandim ishte zbatuar; tri (3) ishin në proces tri (3) nuk janë adresuar ende dhe një (1) i mbyllur i pazabtuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën e rekomandimeve në vijim (nr. 4).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr .	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	<p>Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kabinetin e Kryeministrit dhe Koordinatorin e Task Forcës brenda një afati sa më të shpejtë duhet të bëjnë një analizë gjithëpërfshirëse të realizimit të projektit "Ta pastrojmë Kosovën" dhe të sigurojnë të gjitha raportet financiare dhe raportet tjera të cilat konfirmojnë se të gjitha pagesat e kryera janë të bazuara dhe të mbështetura me dëshmi.</p> <p>Gjithashtu Sekretari i Përgjithshëm duhet siguroj raportet edhe për pagesat që lidhen me dy rastet tjera që ndërlidhen me shpenzimet e varrimit dhe rivarrimit, për te cilat mungojnë dëshmitë e duhura.</p>	<p>Menaxhmenti ka ndërmarrë veprime për të siguruar raportet narrative dhe financiare (janë siguruar kontrata, faturat dhe dëshmi për pagesat e bëra përmes llogarisë bankare).</p> <p>Për shpenzimet e varrimit dhe rivarrimit nuk janë siguruar raporte në lidhje me shpenzimet e ndodhura.</p>	Rekomandimi pjesërisht i zbatuar.
2	PFV	Me rastin e përgatitjes së PFV, Sekretari i Përgjithshëm të siguroj se të gjitha pasuritë janë regjistruar dhe shpalosur në PVF	Përkundër përmbushjes së këtij rekomandimi për rastet e kaluara, këtë vit çështje të njëjta janë përsëritur dhe regjistri i pasurive të shpalosura në PFV nuk është i plotë dhe i saktë, dhe keqklasifikimi i shpenzimeve Shih B1, C3 dhe A11	Rekomandim i pazbatuar
3	Mallrat dhe shërbimet	Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryeshefi ekzekutiv i AUV duhet ndërmarrë veprime për t'u siguruar se angazhimi i zyrtarëve me marrëveshje për shërbime të veçanta /Kontrata pune për detyra specifike, bëhet vetëm në rastet specifike kur ndonjë projekt apo punë e caktuar nuk mund të kryhet me stafin aktual brenda institucionit, dhe angazhimi i tyre të bëhet përmes një procesi transparent dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.	Nuk janë marrë masa Shih B1	Rekomandim i pazbatuar

4	Subvencionet dhe Transferet	Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i ZÇK-së, duhet të sigurojnë që të respektohen rregulloret në fuqi mbi shpenzimin e parasë publike dhe kriteret e përgjithshme të rregullores mbi dhënien e subvencioneve. Po ashtu, duhet të siguroj rritjen e aktiviteteve monitoruese, për të mundësuar respektimin e marrëveshjeve dhe raportimin sipas kërkesave të rregullores.	Gjatë vitit sërish ishin ndarë subvencione pa komision. Në dhjetor ishte formuar një komision por edhe aty kishte vërejtje. Po ashtu, raportimi nuk ishte i plotë Shih C2 dhe B3	Rekomandim i pjesërisht i zbatuar
5	Subvencionet dhe Transferet	Sekretari i përgjithshëm i ZKM-së, Drejtori i ZÇK-së dhe Koordinatori nacional për kulturë, rini dhe sport duhet të sigurojnë që shumata e përfituara në mënyrë të pa drejtë nga OJQ, t'i kthehen buxhetit të ZKM, dhe Zyra për Qeverisje të Mirë të monitoroj procesin e ndarjes së subvencioneve, në mënyrë që të parandalohet dhënia e tyre pa i përmbushur detyrimet nga marrëveshja paraprake, si dhe të mos jepen subvencione të dyfishta për të njëjtin aktivitet.	Menaxhmenti nuk ka ofruar dëshmi që mjetet janë kthyer në buxhetin e ZKM-së. Nuk kemi hasur në raste tjera të kësaj natyre gjatë vitit 2019.	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar
6	Subvencionet dhe transferet	Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i ZÇK-së, duhet të siguroj që të respektohet korniza ligjore në fuqi, respektivisht të mos shpall thirrje publike, para se fondet buxhetore të jenë të disponueshme në llogari bankare.	Nuk kemi hasur në raste të tilla gjatë vitit 2019	Rekomandim i zbatuar
7	Obligimet e papaguara	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që obligimet e mbetura në fund vit duhet të raportohen saktë në PFV, dhe të gjitha faturat të dorëzohen me kohë në shërbimin e financave	Nuk kemi hasur në obligime të cilat nuk janë raportuar, ndërsa kemi hasur në fatura të vonuara për pagesë.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
8	NJAB	Kryeshefi i AUV duhet të mbështetë dhe ndihmoj aktivitetet operative në vazhdim, si dhe të siguroj pjesëmarrjen e AB në takimet e Komitetit të Auditimit. Komiteti i Auditimit duhet t'i	Pjesëmarrja e AB të AUV sërish nuk ka ndodhur në takimet e Komitetit të Auditimit.	Rekomandim i pazbatuar

		rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e dhëna.	
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	
1	PFV	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kërkesave ligjore) dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate.	
2	Pagat dhe mëditjet	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se angazhimi i nëpunësve me marrëveshje për shërbime të veçanta, të bëhet vetëm pasi të jenë vlerësuar dhe arsyetuar nevojat për shërbimet specifike të tyre, dhe më pas, të zhvillohen procedurat e kërkuara ligjore, si dhe duke respektuar afatin e lejuar ligjor për kohëzgjatjen e angazhimit. SP dhe Drejtori i ZÇK duhet t'i rishikojnë pagesat enorme ndaj ekspertit të angazhuar në ZÇK dhe të kërkojnë raporte detaje mujore për kontributet/angazhimin e tij, si dhe të rishqyrtojnë nevojën e angazhimit të tij edhe gjatë vitit 2020 për këtë kompensim jashtë kritereve.	
3	Mallrat dhe shërbimet	Sekretari i Përgjithshëm, duhet të siguroj se në bashkëpunim me Kabinetin e Kryeministrit, të bëhet identifikimi dhe vlerësimi i kërkesave për projektet që drejtohen tek Kryeministri, dhe bazuar në vlerësimin e bërë për këto projekte, ato të planifikohen në buxhetin e rregullt të ZKM-së. Gjithashtu të sigurohet se mjetet nga rezervat, duhet të ndahen vetëm për raste urgjente dhe të paparashikuara, në pajtueshmëri me procedurën e kërkuar në LMFPF.	
4	Mallrat dhe shërbimet	Sekretari i Përgjithshëm, në bashkëpunim me kabinetin e Kryeministrit, duhet të sigurojë se faturat e pranuar për dreka zyrtare nga kabineti, të arsyetohen me dëshmi të mjaftueshme duke përfshirë raportin e pranimit, agjendën e takimit, dhe faturën, me çka arsyetohet se shpenzimet janë bërë për/nga personat e autorizuar dhe për qëllime zyrtare. Në të kundërtën, pagesat e tilla duhet të ndërpriten.	
5	Mallrat dhe shërbimet	Sekretari i Përgjithshëm, në bashkëpunim me kabinetin e Kryeministrit, duhet të siguroj se janë vendosur kontrole rigoroze tek menaxhimi i avanseve për udhëtime zyrtare, në mënyrë që secili shfrytëzues i avansit të bëjë mbylljen e llogarive, respektivisht të barazohet me zyrën e financave, brenda dy javësh pas kthimit nga udhëtimi zyrtar.	

6	Mallrat dhe shërbimet	Drejtori Ekzekutiv i AUV duhet të siguroj që procedurat e vlerësimit të ofertave të përfundohen brenda afateve të parapara kohore, si dhe kontratat të nënshkruhen me kohë, siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi.
7	Subvencionet dhe transferet	Sekretari i Përgjithshëm, duhet të siguroj se për çdo proces të ndarjes së subvencioneve ndaj personave fizik të formohet komisioni i vlerësimit i cili do të bëjë vlerësimin e kërkesave bazuar në dëshmi të mjaftueshme për arsyetimin e dhënies së ndihmës. Në rast të ndryshimit të përbërjes së komisionit, kjo të bëhet përmes vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm.
8	Subvencionet dhe transferet	Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i ZÇK-së, duhet t'i analizojnë shkaqet se pse rastet e mëspërme kanë ndodhur dhe të marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e praktikave të tilla. Gjithashtu, në fazat e ardhme të sigurojnë se përzgjedhja e OJQ-ve bëhet ekskluzivisht në pajtim me kriteret, standardet dhe procedurat e përcaktuara me Rregulloren nr.04/2017.
9	Subvencionet dhe transferet	Sekretari i Përgjithshëm, duhet të siguroj se në rastet e thirrjeve publike për OJQ-të, të respektohen të gjitha kriteret e përcaktuara sipas thirrjes publike gjatë vlerësimit të aplikacioneve nga komisioni përkatës i vlerësimit.
10	Subvencionet dhe transferet	Sekretari i Përgjithshëm, duhet të siguroj se OJQ-të e përzgjedhura në listën preliminare, të sigurojnë gjithë dokumentacionin që kërkohet pas shpalljes së rezultateve preliminare sipas kërkesave të rregullores në fuqi.
11	Subvencionet dhe transferet	Sekretari i Përgjithshëm, të siguroj ndërmarrjen e masave shtesë ndaj monitorimit të përfituesve nga personat fizik dhe OJQ-të, për sigurimin e dëshmive të vlefshme lidhur me shfrytëzimin e mjeteve, në përputhje me qëllimin e dhënë. Nëse këto nuk arsyetohen brenda periudhës së definuar në kontratë, të ndërmerren masa ndëshkuese ndaj këtyre përfituesve, sic janë të përcaktuara në programin e miratuar për komunitete.
12	Investimet Kapitale	Sekretari i Përgjithshëm, duhet të siguroj se vlerësimi i tenderëve bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe vetëm operatorët e përgjegjshëm në të gjitha kërkesat shpallen fitues.
13	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Drejtori Ekzekutiv në AUV, duhet të ndërmerr masa që të gjitha furnizimet fillimisht pranohen në depon qendrore ku dhe regjistrohen në sistem, më pas shpërndahen në sektorët e caktuar sipas kërkesës. Gjithashtu, të siguroj se regjistrat e pasurive të jenë të plotë dhe të saktë.

		Ndërsa, Kryeshefi Ekzekutiv në ASK, të siguroj se blerjet mbi 1000€ realizohen nga kategoria e investimeve kapitale dhe si të tilla, regjistrohen në regjistrin kontabël.
14	Obligimet e papaguara	Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori Ekzekutiv në AUV, të sigurojnë se te gjitha faturat e pranuar, të paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër Konfirmimi

REPUBLICAN ARCHIVES - REPUBLICAN ARCHIVES - REPUBLIC OF KOSOVA DRYTINA E ARSHIVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA ZYRA KRYEMINISTRIT QESH PRIMEJER, OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARSHIVES - SEKTOR ARSHIVE - ARCHIVE SECTION	
Nr. Dreg. Org./Unit 02	Nr. Dreg. Org./Unit 660
Nr. i Fajese No. pages 90	Data Date 12 / 05 / 20 20
Prishtine/0	



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Sekretari i Përgjithshëm - Generalni Sekretar - Secretary General

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare Vjetore të Zyrës së Kryeministrit, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Fitim Krasniqi,.....
 Sekretar i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës,
 Datë: 12.05.2020. Prishtinë